



# EKO SHKOLLA


- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

## EKO KLUBI

## "LASGUSH PORADECI"

# 2





Të dashur lexues,

Kjo është seria e dytë e buletineve mjedisore të eko-klubevetë shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i IAAP "Lasgush Poradeci" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimeve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



# MBROJTJA E OQEANEVE

Oqeani si pjesë e pandashme e mjedisit jetësor ka shumë benefite për jetesën e organizmave brenda dhe jasht tij. Në vazhdim do të përmendim disa prej benefiteve që na i ofron oqeani.

Oqeani është trupi i ujit të kripur që mbulon afërsisht 70.8% të sipërfaqes së Tokës dhe përmban 97% të ujit të Tokës. Një oqean mund t'i referohet gjithashtu ndonjë prej trupave të mëdhenj ujorë në të cilët ndahet në mënyrë konvencionale oqeani botëror.

Cilat janë dëmet e njerëzve ndaj oqeanëve?

Pavarësisht të mirave që na i ofron oqeani ne prap se prap nuk ndalemi së dëmtuari atë dhe e gjitha kjo nuk është vetëm në dëm të oqeanit por edhe në dëm të gjallesave brenda dhe jasht tij, duke përfshirë këtu edhe njerëzit. Ne vazhdim do të përmendim disa dëme që i bëhen oqeanit nga njerëzit.

## Disa dëme të njeriut ndaj Oqeanëve:

- Hedhja e mbeturinave të ndryshme nëpër ujërat e deteve dhe oqeanëve.



- Derdhja e ujërave dhe lëndëve të ndryshme të ndotura nëpër dete dhe oqeanë.



- Ngritja e klimës globale nga gazra të ndryshme duke shkaktuar shkrirjen e akullnajave në dy polet, atë të jugut dhe atë të veriut. Duke shkaktuar rritjen e nivelit të ujërave dhe vërshime të shpeshta.



## Dëmet ndaj gjallesave:

- Mbeturinat:



- Ujërat dhe lëndët e ndotura:



- Shkrirja e akullnajave dhe vërshimet:






# SI MUND T'I MBROJTMË OQEANET

## Benefitet:




### Prodhon Oksigjen

Shkencëtarët vlerësojnë se 50-80% e prodhimit të oksigjenit në Tokë vjen nga oqeani.




### Produkte Ushqimore

Siguron produkte ushqimore si: ujë, ushqime detare dhe kripëra



### Përmirësim të Temperaturave

Oqeani vepron si një rrip transportues, duke transportuar ujë të ngrohtë nga ekuatori drejt poleve dhe ujë të ftohtë nga polet përsëri në tropikët.



### Burime Natyrore dhe Minerale

Oqeani ofron Naftë, Gaze Natyrore dhe Minerale të Ndryshme.



### Vende Pune

Oqeani siguron disa punë si: Zhytësi komercia, Peshkatar, Hidrolog, biolog detar, Arkitekt detar etj.

Mbrojtja e oqanit duhet bërë në nivel global dhe nga të gjithë njerëzit që jetojnë dhe veprojnë në Tokë. Vetëdijësimi i njerëzve do të ishte si hap primar për kthimin e pastërtisë në nivel normal dhe ndaljen e gjithë këtyre dëmeve të natyrës nga njeriu.

Të përfundonte përdorimi i gjësendeve njëpërdorimëshe plastike dhe të shtoheshin fabrikat dhe mjetet recikluese nëpër shumë vende.

Pastaj të fillonte pastrimi i liqenjëve, lumenjëve, deteve dhe oqeanëve nga mbeturinat e ndryshme prej njerëzve vullnetarë në të gjithë globin. Kjo do të ndikonte në normalizimin dhe zvogëlimin e problemeve të ujërave në botë.






# AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE  
EC MA NDRYSHE







## DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.








## DITA BOTËTORE E RUAJTJES SË MJEDISIT

Ky eveniment shënohet çdo vit me datën 28 korrik. Në këtë ngjarje, eko klubet e shkollave të mesme të Prizrenit, Rahovecit dhe Malishevës janë angazhuar për të kryer pastrimin. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në një prezantim me informacione të rëndësishme rreth Ditës Botërore të Ruajtjes së Natyrës. Ata gjithashtu kanë diskutuar me mësuesit mbi çështjet e ndotjes së natyrës në komunitetin e tyre. Në veçanti, ata shprehen shqetësime për ndotjen e pyjeve dhe ujërave, të cilat po shkatërrojnë habitate të shumta të florës dhe faunës nëpër komunat e tyre.

Në këtë diskutim, janë përmendur disa hapa të nevojshëm për të përmirësuar situatën, duke përfshirë rritjen e vetëdijes së komunitetit për këto çështje dhe ndëshkimin e duhur nga institucionet ndaj ata që shkaktojnë ndotjen.







## INAGURIMI I PROJEKTIT MJEDISOR

Eko klubi i shkollës së mesme “Lasgush Poradeci” në Kijevë ka realizuar projektin mjedisor. Me anë të këtij projekti nxënësit kanë rritur hapësirën e gjelbër në shkollën e tyre duke mbjellur drunjë dhe bimë shumëvjeçare, kanë vendosur ulse dhe kanë investuar në sistemin e ujitjes për të rritur qëndrueshmërinë e investimit të realizuar.

Qëllim i këtij projekti përveç tjerash ishte edhe aktivizimi mjedisor i nxënësve, të cilët gjatë aktivitetit ndihmuan në procesin e mbjelljes së drunjëve dhe kanë pastruar hapësirën përreth shkollës, duke i bërë kështu të ndjehen përgjegjës për intervenimin e realizuar.





# **EKO KLUBI "LASGUSH PORADECI"** **KIJEVË, MALISHEVË**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe  
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,  
Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".